

AKT THEMELIMI dhe STATUT

TOPKËMBA SHPK

Sot, më datë 16 mars 2024, i nënshkruari **Denis Meço**, i biri i **Besnik** dhe **Etleva**, i lindur më **19/08/1995** në **Korçë, Shqipëri**, banues në adresën **Rruga "Bedri Karapici", Kompleksi "Tirana Golden Park", Seksioni 2, Kati 7, Apartamenti 60, Njësia Administrative Nr. 6, 1022, Tiranë, SHQIPËRI**, me kombësi **shqiptare**, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **J50819079B**, me vullnetin e tij të lirë dhe bazuar në legjislacionin shqiptar, në cilësinë e **ortakut të vetëm**, vendosi të hartojë këtë akt themelimi dhe statut të shoqërisë **TOPKËMBA SHPK**.

Neni 1

Emri, forma, data e themelimit, kohëzgjatja dhe prishja e shoqërisë

1.1 Emri i shoqërisë është **TOPKËMBA** dhe ndiqet në mënyrë të pandashme nga shkurtimi **SHPK**, i cili përfaqëson formën ligjore të saj.

1.2 Shoqëria ka formën ligjore të një **shoqërie me përgjegjësi të kufizuar**, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

1.3 Emri dhe forma ligjore e shoqërisë mund të ndryshohen në të ardhmen me vendim të ortakut të vetëm.

1.4 Shoqëria është themeluar më datë **16 mars 2024** dhe do të ushtrojë aktivitetin e saj për një **kohëzgjatje të papërcaktuar** duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

1.5 Në rast të prishjes së shoqërisë, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.


Neni 2

Selia

2.1 Selia e shoqërisë është në adresën **Rruga "Bedri Karapici", Kompleksi "Tirana Golden Park", Seksioni 2, Kati 7, Apartamenti 60, Njësia Administrative Nr. 6, 1022, Tiranë, SHQIPËRI**.

2.2 Adresa e selisë mund të ndryshohet në të ardhmen me vendim të ortakut të vetëm.

2.3 Shoqëria mund të hapë degë të saj dhe/ose zyra përfaqësimi kudo, brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke ushtruar veprimtarinë në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.



Neni 3

Kapitali themeltar dhe ortaku i vetëm

3.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **700,000 (shtatëqind mijë) Lekë**.

3.2 Numri i kuotave të kapitalit është **1 (një)**.

3.3 Ortaku i vetëm i shoqërisë është **Denis Meço**, i biri i **Besnik** dhe **Etleva**, i lindur më **19/08/1995** në **Korçë, Shqipëri**, banues në adresën **Rruga "Bedri Karapici", Kompleksi "Tirana Golden Park", Seksioni 2, Kati 7, Apartamenti 60, Njësia Administrative Nr. 6, 1022, Tiranë, SHQIPËRI**, me kombësi **shqiptare**, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **J50819079B**, zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme **700,000 (shtatëqind mijë) Lekë** që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

3.3 Kapitali themeltar i shoqërisë do të paguhet nëpërmjet llogarisë së saj bankare menjëherë pasi shoqëria të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

3.4 Kapitali i shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet në të ardhmen me vendim të ortakut të vetëm, por në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se minimumi i përcaktuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

3.5 Numri i kuotave të kapitalit mund të rritet në të ardhmen me vendim të ortakut të vetëm, i cili mund të ndryshojë pronësinë e shoqërisë nga një shoqëri me një ortak të vetëm në një shoqëri me dy ose me shumë ortakë.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë


4.1 Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në fushën e **tregtimit online me pakicë dhe/ose shumicë të mallrave të ndryshëm** të lejuar me ligj.

4.2 Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në fushën e **medias sportive për informimin publik online** dhe ofron **hapësirë reklamuese në mjetet e saj të komunikimit** (faqe interneti, rrjete sociale).

4.3 Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në fushën e **këshillimit financiar për bizneset dhe/ose individët**.

4.4 Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në fushën e **këshillimit online për lojtarët e basteve sportive**.

4.5 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshojë në të ardhmen me vendim të ortakut të vetëm.



Neni 5 Organet drejtuese

5.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë **Ortaku i vetëm** dhe **Administratorët**.

5.2 Ortaku i vetëm i shoqërisë, **Denis Meço**, është emëruar të kryejë edhe rolin e Administratorit për një periudhë **5 (pesë)** vjeçare.

5.3 Me vendim të ortakut të vetëm, shoqëria mund të emërojë edhe më shumë se një administrator. Administratorët e shoqërisë mund t'i ushtrojnë kompetencat e tyre bashkarisht ose të ndarë, në varësi të përcaktimeve të bëra nga ortaku i vetëm.

Neni 6 Të drejtat dhe detyrimet e ortakut të vetëm

6.1 Ortaku i vetëm është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:


- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

6.2 Ortaku i vetëm merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

6.3 Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur



shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve

7.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortakut i vetëm;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 8

Dispozitat e fundit

8.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën **shqipe** dhe secila kopje ka fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKU I VETËM THEMELUES TOPKËMBA SHPK

Denis Meço

Denis Meço

